REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

DPS
Nr 405 Dos 10
Dt. 18.11.2026 Vt.

VENDIM

Nr. 864, datë 12.11.2026

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 27.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VEPRIMTARITË E STANDARDIZIMIT", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr.9870, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rregulloren "Për veprimtarinë e standardizimit", bashkëlidhur vendimit nr.382, datë 27.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për veprimtaritë e standardizimit", të ndryshuar", bëhen këto ndryshime:

   a) Pika 6.2.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

   "6.2.1. Kur autoritetet shqiptare, përfshirë DPS-në ose ministrinë përgjegjëse, vlerësojnë se një standard shqiptar i harmonizuar nuk përmbush plotësisht kërkesat që synon të mbulojë dhe të cilat përcaktohen në legjislacionin përkatës (rregullat teknike), DPS-ja informon Komisionin, duke dhënë një shpjegim të hollësishëm. Vendimi i Komisionit zbatohet nga ministria përkatëse.".

   b) Fjalia hyrëse e pikës 9.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

   "9.2. Financimi nga Bashkimi Evropian mund të ofrohet gjithashtu për:"

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ALBANA KOÇIU

MINISTRI I EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

NR.PROT. 5916/4
DATË 12.11 .2026

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsonida RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE